



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Ligji Nr. 08/L - 195

PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES NDËRMJET MINISTRISË SË MBROJTJES SË MBRETËRISË SË BASHKUAR TË BRITANISË SË MADHE DHE IRLANDËS VERIORE DHE MINISTRISË SË MBROJTJES, NË EMËR TË QEVERISË SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, LIDHUR ME ATASHIMIN E PERSONELIT NGA FORCA E SIGURISË SË KOSOVËS NË KOMPANINË ROULEMENT TË KËMBËSORISË NË ISHUJT FALKLAND

Kuvendi i Republikës së Kosovës;

Në mbështetje të neneve 18 dhe 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miratton:

LIGJ PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES NDËRMJET MINISTRISË SË MBROJTJES SË MBRETËRISË SË BASHKUAR TË BRITANISË SË MADHE DHE IRLANDËS VERIORE DHE MINISTRISË SË MBROJTJES, NË EMËR TË QEVERISË SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, LIDHUR ME ATASHIMIN E PERSONELIT NGA FORCA E SIGURISË SË KOSOVËS NË KOMPANINË ROULEMENT TË KËMBËSORISË NË ISHUJT FALKLAND

Neni 1
Qëllimi

Ky ligj ka për qëllim të ratifikojë marrëveshjen ndërmjet Ministrisë së Mbrojtjes së Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës Veriore dhe Ministrisë së Mbrojtjes, në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës, lidhur me atashimin e personelit nga Forca e Sigurisë së Kosovës në Kompaninë Roulement të Këmbësorisë në ishujt Falkland.

Neni 2
Ratifikimi i marrëveshjes

Ratifikohet marrëveshja ndërmjet Ministrisë së Mbrojtjes së Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës Veriore dhe Ministrisë së Mbrojtjes, në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës, për atashimin e personelit nga Forca e Sigurisë së Kosovës në Kompaninë Roulement të Këmbësorisë në ishujt Falkland, e lidhur më datë 22 nëntor 2022.

Neni 3
Dokumentet e bashkëngjitura

Bashkëngjitur me këtë ligj është marrëveshja ndërmjet Ministrisë së Mbrojtjes së Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës Veriore dhe Ministrisë së Mbrojtjes, në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës, lidhur me atashimin e personelit nga Forca e Sigurisë së Kosovës në Kompaninë Roulement të Këmbësorisë në ishujt Falkland.

Neni 4
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ligji Nr. 08/L-195
24 nëntor 2022

Glauk KONJUFCA

Kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës